

496/22 Data 15-12-2022



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government  
 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -  
 Ministry of Finance, Labour and Transfers  
 Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



**ADMINISTRATA TATIMORE e KOSOVËS (ATK)-** Divizioni i Ankesave në përbërje të panelit shqyrtues: Shefqet Muja kryesues, Ramadan Ahmeti dhe Ilona Mrasori anëtarë, duke vendosur në çështjen administrative tatimore sipas ankesës së subjektit tatimor [REDACTED] me numër fiskal (NUI): [REDACTED] me seli në adresë : Rr. [REDACTED] e dorëzuar ne post me datë 23.11.2022 e përcjell në Divizionin e Ankesave me datë: 01.12.2022 me nr. protokolli 496/2022 në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 03/L-222 mbi “Administratën Tatimore dhe Procedurat”, kundër Vendimit te lëshuar nga Zgjona me 2007/2022 i datës: 12.09.2022 për në vlerë prej 125.00 €, i lëshuar nga Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime e ATK-së , Regjioni Prishtina 1, mori këtë :

#### VENDIM

I. Refuzohet ankesa nr. 496/2022, e subjektit “[REDACTED]” me numër fiskal (NUI): [REDACTED] me seli në adresë : Rr. [REDACTED], në mbështetje të nenit 132/2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurat Administrative në lidhje me nenit 89, paragrafin 2, të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat,

II. Vendimit nga Zgjona Nr2007/2022 i datës: 12.09.2022 për në vlerë prej 125.00 €, i lëshuar nga Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime e ATK-së , Regjioni Prishtina 1, vërtetohet si i bazuar.

#### Arsyetim

Tatimpaguesi ka dorëzuar ankesë me postë me datë 23.11.2022 e përcjell në Divizionin e Ankesave me datë: 01.12.2022 ,ndëshkimi nga Zgjona ju është dorëzuar me datë: 24.10.2022,që për rrjedhojë ankesa është parashtruar në afatin ligjor e përcaktuar me Nenin 77.2 te Ligjit 03/L-222 “Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat Tatimore”, Nenin 44 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010 Për Zbatimin e Ligjit nr. 03/L-222.

Tatimpaguesi në ankesën e parashtruar me shkrim shkruan: Vendimi me numër protokolli 2007/2022 datë 12.09.2022 është pranuar me datën 24.10.2022 me të Cilin vendim Biznesit individual me NUI [REDACTED], i shqiptohet kundërvajtje në shumën prej 125.00€ për shkak të shkeljeve ligjore: Ligjit Nr.03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-102 dhe 04/L-223.Andaj, duke u bazuar në nenin 54 par 1 të Ligjit Nr.05/L-087 të Ligjit për Kundërvajtje, në afatin e paraparë ligjorë paraqesë këtë: Ankesë për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës së kundërvajtjes; aplikimit të gabueshëm të ligjit material, me të Cilin është paraparë kundërvajtja; vërtetimit të gabueshëm ose vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike; Me propozim Që të APROVOJË në tërësi ankesën time si të bazuar dhe të anuloj vendimin me nr. protokolli 2007/2022 dt.12.09.2022 me arsyetim se: Inspektorët e Administratës Tatimore të Kosovës nga zyra për gjoba dhe ndëshkime/Zyra regjionale e Pr 1, Pr-2, Pr-3

dhe DTM, kanë shkuar në rr. [REDAKTUAR] më saktësisht në afërsi të Ambulancës Specialistike [REDAKTUAR] me datën 30.08.2022 (ndërsa Inspektorët tatimor kanë paraqitur se inspektimi është bërë me datën 01.09.2022) dhe të njëjtit më kanë thirr në telefon në numër [REDAKTUAR] në numrin tim persona [REDAKTUAR] dhe më është prezantuar me emrin Ragip. Unë isha në shtëpi dhe pasi Ambulanca është në shtëpinë time unë dola menjëherë dhe çdo herë duke menduar se ishte djali i tezes Ragipi. Posa dola unë pash dy persona dhe te njëjtit më thanë ta hapë ambulancën pasi jemi nga ATK-ja dhe duhet me inspektua- Unë pa asnjë hezitim kam hapur derën e ambulancës dhe te njëjtit kanë hyrë brenda. Pasi hyrën brenda të njëjtit kërkuan dokumentacionin të cilin unë nuk e kisha në ambulancë por të njëjtin ja u tregova me telefon, dokumentacionin e kisha në shtëpi pasi unë nuk kam filluar me shërbime ende në ambulancë.

Unë i njoftova inspektorët se Ambulanca nuk është funksionale dhe se ende jam në kompletim e sipër dhe nuk posedoj as arkë fiskale, gjithashtu jua dëshmoja se edhe licencën e kam marrë para pak dite dhe kur isha në kompletim e sipër të ambulancës mua më lindën probleme familjare ku motrën e kisha në komë dhe nuk kisha kohë të merrem me ambulancën. Te njëjtit gjatë bisedës më thanë se në rregull doktor por ti duhet të pajisesh me arkë fiskale para se të fillosh me shërbime.

Unë procesverbalin te cilin ma kanë ofruar e kam nënshkruar duke ju besuar fjalëve të tyre dhe të njëjtin nuk e kam lexuar fare, duke menduar se te njëjtit e kanë paraqitur situatën reale, kur kihet parasysh se ambulanca nuk ka qenë duke punuar, ende nuk ka qenë e kompletuar, unë nuk kam qenë në ambulancë por në shtëpi, ambulanca është hapur me kërkesë të tyre, dhe duke pasur parasysh problemet familjare, te njëjtit më kanë vënë në lajthim dhe unë pa asnjë hezitim e kam nënshkruar.

Me datë 12.09.2022 është marrë vendimi ku [REDAKTUAR] I pronar i biznesit Hamdi Ramadani, i shqiptohet ndëshkim administrativ në vlerë 125 euro për mos lëshim të kuponit fiskal, e ku i njëjti nuk është pajtuar me konstatimin e inspektoratit dhe sipas opinionit të tatimpaguesit ndëshkimi do të ishte i padrejtë, pasi që "Si mundet të lëshoj kupon fiskal një ambulancë speciali stike e cila nuk është funksionale, inspektorët jo që nuk kanë gjetur ambulancën duke punuar, ku sikur të kishte qenë hapur dhe të kishte të paktën një pacient do të mund të thirrëshin se kam shkelur ligjin por te njëjtit më kanë thirr në telefon me kanë detyruar ta hapë ambulancën dhe pastaj më fillojnë procedurën kundërvajtësi". Andaj, duke marrë parasysh të cekurat më lartë, vërtetohet se: Inspektorët tatimor nuk kanë kryer detyrën e tyre siç kërkohet me ligjin e tyre pasi Ambulanca hapet me kërkesën e tyre për inspektim, ambulanca nuk ka qenë funksionale, në të nuk është kryer asnjë shërbim, dhe me këtë rast inspektorët kanë bërë vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Lëshimi i ndëshkimit : Në AU005 datë: 29.08.2022 inspektori tatimor nder te tjera shkruan:

Qëllimi i vizitës ishte për të verifikuar se tatimpaguesi a është i pajisur me PEF,, gjatë vizitës konstatuam se ky tatimpagues nuk është i fiskalizuar dhe tatimpaguesi ka vepruar në kundërshtim me Nenin 13 paragrafi 6 i Ligjit Nr.03/L-222 dhe nenit 4 paragrafi 1.1 dhe 1.3 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2008.

Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime Administrative me datë: 12.09.2022 duke u bazuar ne AU005-in e inspektorit ka lëshuar Vendimin për lëshimin e gjobës Nr:2007/2022 në të cilën potencohet se tatimpaguesi ndëshkohet në vlerën prej 125.00 € dhe ka ardhur në konstatim se subjekti ne fjale ka vepruar ne kundërshtim te dispozitave Ligjore te përcaktuara ne Ligjin Nr.

03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe 04/L-223 dhe ndëshkohet si ne vijim:

Neni 13.6 i Ligjit Nr.03/L-222, neni 43 paragrafi 103 i Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2010. Dhe ndëshkohet bazuar në Nenin 53(53.6) të Ligjit Nr.03/L-222. Andaj bazuar ne te gjitha faktet e cekura me sipër dhe ne përputhje me dispozitat Ligjor, Zyra për Gjoba dhe Ndëshkime Administrative, vendosi si ne diapozitiv te këtij vendimi,

Administrata Tatimore -Departamenti i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave në lëndë si dhe pretendimeve ankimore konstaton se: Ankesa e tatimpaguesit është e pa bazuar.

Departamenti i Ankesave pas verifikimit të shkresave në lëndë vendosi që tatimpaguesi të mbetet obligues i vendosjes së ndëshkimit sipas Vendimit Nr. 2007/2022 në vlerë 125.00 € të datës 12.09.2022 i lëshuar në përputhshmëri sipas nenit 53.6 të Ligjit Nr.03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Sipas paragrafit 6, Neni 53 të Ligjit Nr.03/L-222 parashihet, citojmë: *“Çdo person i cili kërkohet të vendosë një pajisje elektronike fiskale për regjistrimin e transaksioneve të bëra gjatë aktivitetit të tyre ekonomik dhe i cili nuk i lëshon klientit të vet kupon nga pajisja e tillë e fiskalizuar, do të detyrohet për një gjobë të përcaktuar në përputhje me dispozitat e paragrafit 2. të këtij neni. Në rast të dështimit të pajisjes apo rrymës, duhet të lëshohen kuponët e shkruar me dorë të cilët janë miratuar nga Administrata Tatimore në vend të kuponit të lëshuar nga një pajisje elektronike fiskale, që i nënshtrohet ndëshkimit të përshkruar në këtë paragraf”.*

Divizioni i Ankesave vërteton, duke u bazuar në dispozitat ligjore tatimpaguesi është i obliguar të lëshoj kuponë fiskal me rastin e shërbimit të klientëve dhe atë bazuar në dispozitat ligjore të neni 4 paragrafi 1.1 i Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018 i cili nen parasheh:

*1.1 Të gjithë personat që bëjnë furnizime të mallrave dhe/ose shërbimeve në objektet, njësitë ose vendet të cilat mund të jenë në qasje të publikut, janë të obliguar që të shfrytëzojnë PEF dhe pajisjet tjera të obligueshme për regjistrimin dhe vërtetimin e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve. Ndërsa neni 4 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 parasheh:”*  
*1.4 Printimi dhe dhënia e kuponëve fiskal konsumatorëve është i detyrueshëm në momentin e regjistrimit të furnizimit në PEF;*

Departamenti i Ankesave sqaron tatimpaguesit se ATK-ja në vazhdimësi ka njoftuar përmes mediave si dhe Web. faqes së ATK-së për personat e obliguar për pajisje me arke fiskale. Përderisa tatimpaguesi nuk është pajisur me PEF, nuk ka lëshuar kupon fiskal sipas dispozitave të parapara ligjore, lëshimi i ndëshkimeve është i bazuar në Nenin 27 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018, i cili ka përcaktuar gjobat dhe ndëshkimet për shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, si dhe paragrafin 6, të Neni 53, dhe paragrafi 1 i neni 53 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat për mos lëshim të kuponëve fiskal dhe mos dorëzim të pasqyrës së informatave për faktin se nuk ka pajisje me arke fiskale.

Pretendimet e tatimpaguesit se ambulanta ka qen e mbyllur dhe nuk ka punuar, Divizioni i Ankesave për te verifikuar kemi kërkuar sqarime shtesë nga inspektori i vizitës lidhur me këto pretendime, Nga Inspektori jemi njoftuar se ne momentin e vizitës ambulanta ishte e hapur me derën qel jemi hy brenda kemi trokit disa here brenda dhe nuk është lajmëruar askush. Ne mungesë te përgjigjes kemi thirrur ne telefonin që posedonte ne derën hyrës te ambulancës, pas thirrjes rreth 5 – 7 minuta kemi kontaktua me tatimpaguesin ,i cili deklaroi te kontabilisti e kemi dokumentacionin ,punëtores është Selvete Sejda dhe se nuk kam shumë pune mirëpo ka pacient që vine për trajtim, ndërsa Ambulant ishte e pajisur me inventar për te punuar

Andaj duk u bazuar me këto sqarime të sipërshënuara vërtetohet se tatimpaguesi, ka bërë shkelje ligjore dhe nuk i është përmbajtur dispozitave të sipërshënuara ligjore prandaj mbetet obligues i ndëshkimit të lëshuara për mos pajisje me arke fiskale në vlerën prej 125.00 € sipas Vendimit Nr.2007/2022 i datës 12.09.2022.

Sipas të dhënave të cekura më lartë u vendos si në diapozitiv të këtij vendimi bazuar në Nenin 132 paragrafi 2 i LPA-Nr. 05/L-031.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Bazuar në nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-102 "Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr. 03/L-222, pala e pakënaqur ka të drejtë që brenda afatit tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimin të vendimit të Departamentit të Ankesave, ta kundërshtojë këtë vendim tek Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

**DIVIZIONI I ANKESAVE NË PRISHTINË**  
Nr: 496/2022 datë 15.12.2022

Vendimi t'iu dorëzohet :

1. Tatimpaguesit
2. Administratës Tatimore

Udhëheqësi i Divizionit të Ankesave  
Skender Krasniqi \_\_\_\_\_

Kryesuesi i rastit  
Shefqet Muja \_\_\_\_\_

